



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion

Nën-komisioni për Mandate, Imunitete dhe Rregulloren e Kuvendit

Mbledhja nr. 01

Prishtinë, më 21 mars 2011, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-225

P R O C E S V E R B A L

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

Nënkomisioni për Mandate, Imunitete dhe Rregulloren e Kuvendit

Në mbledhje morën pjesë: Arben Gashi – kryetar, Arsim Bajram, Mufera Şinik, Behar Selimi, Halit Krasniqi, Haki Demolli, Armend Zemaj, Albulena Haxhiu, Ardian Gjini, Ibrahim Makolli dhe Jasmina Živković.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Petrit Hysaj - OSBE, Lumnije Murati – ZPRK, Rinor Beka - NDI, Floriana Shala – OSBE, Isuf Zejna – KDI, Vlora Marmullakaj – EULEX, Artan Canhasi - EULEX, Fixhrije Dragaj – praktikante.

Nga Stafi i Komisionit për Legjislacion - Nënkomisioni për Mandate, Imunitete dhe Rregulloren e Kuvendit: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni, Visar Krasniqi, Hasan Tahiri dhe Advie Morina

Mbledhjen e kryesoi: Arben Gashi, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Konstituimi i Komisionit,
3. Formimi i nën-komisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregullore,
4. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Konstituimi i Komisionit

Kryetari – I përshëndeti anëtarët e Komisionit dhe pjesëmarrësit e tjerë, si dhe i njoftoi me vendimin e Kuvendit nr. 04-V-007 të datës 10 mars 2011 lidhur me përbërjen e Komisionit. Theksoi se kualitetet profesionale, që përfshihen në këtë Komision, do të jenë në interes të Kuvendit, por edhe të qytetarëve të Kosovës. Në vazhdim theksoi se në kuadër të ndryshimeve, që kanë ndodhur në komisionet e Kuvendit, është paraparë që si nënkomision të jetë, Nënkomisioni për Mandate, Imunitete dhe Rregulloren e Kuvendit. Në vazhdim foli për Agjencinë Kundër Korrupsionit, të cilit si komision duhet t'i kushtohet vëmendje gjatë kësaj legjislature, sepse ka një ndjeshmëri më të madhe në opinion lidhur me funksionalitetin e tij. Andaj brenda fushëveprimit të Komisionit do të shikohet mundësia e gjetjes së mundësive për funksionalizimin më të mirë të kësaj Agjencie. Kjo le të mbetet e hapur për takimet e radhës si do të organizohet puna e Komisionit.

Lidhur me këtë pikë Komisioni e nxori këtë:

PËRFUNDIM

U konstitua Komisioni për Legjislacion në pajtim me vendimin e Kuvendit nr. 04-V-007, të datës 10 mars 2011.

3. Formimi i Nënkomisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregullore

Kryetari - Lidhur me formimin e Nënkomisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregullore, kërkoj nga grupet parlamentare të propozohet nga një anëtarë për Nënkomisionin, që sipas nevojës do të organizojë takime.

Ardian Gjini - Ishte i mendimit se propozimi i anëtarëve të Nënkomisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregullore është punë e lehtë dhe se propozimi i tyre mund të bëhet sot.

Arsim Bajrami - Në emër të grupit parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, për anëtar të Nënkomisionit e propozoi Behar Selimin.

Kryetari - Në emër të grupit parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, për anëtar të Nënkomisionit e propozoi Armend Zemajn.

Albulena Haxhiu - Në emër të grupit parlamentar të Vetëvendosjes, tha se pas konsultimeve me grupin parlamentar, në takimin e radhës, do ta sjellë propozimin për anëtar të Nënkomisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregullore.

Lidhur me këtë pikë Komisioni e nxori këtë:

PËRFUNDIM

Komisioni vendosi që formimi i Nënkomisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të bëhet në mbledhjen e radhës, pasi grupi parlamentar i Vetëvendosjes ta sjellë propozimin e tij.

4. Të ndryshme

Armend Zemaj - Duke folur për Agjencinë Kundër Korrupsionit tha se kishte qenë ndër hartuesit e ligjit për Agjencinë. Sipas ligjit ishte paraparë të formohej një komision përkatës, për ta mbikëqyrur punën e Agjencisë, ku ishet përfshirë edhe pjesa e deklarimit financiar. Ishte i mendimit se punën duhet ta kryejnë si Komision, si me rastin raportimit të Agjencisë ashtu edhe në përzgjedhjen e drejtorit, sepse kjo e rrit efikasitetin e punës.

Ibrahim Makolli - Ishte i mendimit se duhet të përgatitet për mbledhjen e radhës një draft për aktivitetet e Komisionit për këtë vit. Në vazhdim tha se është e nevojshme edhe hartimi i një plani të punës, që ka të bëjë me Agjencinë Kundër Korrupsionit, sepse tash edhe po afrohet koha kur ata duhet të raportojnë në Komision. Shtoi se nuk është vetëm kjo Agjenci, por ka edhe agjenci të tjera të pavarura që i raportojnë Komisionit.

Kryetari - Për planin e punës së Komisionit tha se drafti i tij pritet të plotësohet posa të vijë Strategjia legjislative e Qeverisë për vitin 2011.

Arsim Bajrami - Tha se ky Komision do të jetë aktiv edhe në sponsorizimin e ligjeve, duke mos pritur që gjithmonë Qeveria të sjellë ligjet, sepse jemi Komision i autorizuar ta marrim sponsorizimin e ligjeve. Në vazhdim e përmendi nevojën e rishikimit të Rregullores së Kuvendit dhe çështjen e reformës zgjedhore, sepse jemi Komisioni kryesor, që duhet ta japë kontributin në këtë drejtim. Rreth çështjes së mbikëqyrjes, tha se duhet të kihet kujdes sepse agjencitë e pavarura nuk mbikëqyren, por raportojnë për punën e tyre.

Ardian Gjini - U pajtua me parafolësit që çështja e mbikëqyrjes të jetë e përfshirë në planin e punës së paku 2 - 3 herë brenda vitit. Duke folur për Agjencinë tha se ai është i pavarur, sepse Kuvendi e ka themeluar, mirëpo Kuvendi nëpërmjet Komisionit ka të drejtë ta mbikëqyrë sa po përmbushen objektivat që i janë parashtruar kësaj Agjencie.

Albulena Haxhiu – U pajtuam me idenë se duhet të ketë një mbikëqyrje të Agjencionit Kundër Korrupsionit duke pas parasysh shkallen e lartë të korrupsionit në Kosovë.

Behar Selimi – I përshëndeti anëtarët e Komisionit dhe të pranishmit. Tha se ndihet mirë që është anëtar i këtij Komisioni. Shpreson se do të ketë bashkëpunim të mirë dhe partneritet, do të jetë një vit i ngjeshur, sepse tani se shpejti do ta kenë Strategjinë legjislative për këtë vit. Mbikëqyrja e ekzekutivit do të ishte mirë të bëhet nëse do t'ia arrimë këtij qëllimi. Ndërsa duke folur rreth mbikëqyrjes së Agjencisë nëpërmjet raportimit, theksoi se është mbikëqyrje e moderuar e përcjellë me debat, e jo mbikëqyrje klasike.

Armend Zemaj – Për Projektligjin e buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2011, propozoi të mbahet mbledhja më 23. 3. 2011.

Lidhur me këtë pikë Komisioni e nxori këtë:

PËRFUNDIM

I. Komisioni vendosi ta mbajë mbledhjen e radhës më 23. 3. 2011 për shqyrtimin e Projektligjit për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2011.

II. Komisioni vendosi që mbledhjet e Komisionit parimisht të mbahen çdo të hënë, në orën 11: 00.

Mbledhja përfundoi në orën 13:35

Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Arben Gashi